



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Skenderajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skenderajt (SK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpenzime në vlerë 493,807€ janë paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate.
- B2 Detyrimet kontigjente të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare janë mbivlerësuar për 127,978€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Skenderajt kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Mangësi në përgatitjen e specifikacionit teknik dhe mungesë e projektit detaj ekzekutues për kontratën e punëve.
- A2 Mangësi në fushën e menaxhimit të personelit.
- B3 Mos vazhdimi i sigurimit të ekzekutimit të kontratave publike.
- C1 Subvencionim i OJQ-së dy herë brenda vitit buxhetor.
- B4 Mos vlerësimi i performancës së kontraktuesve përmes platformës e-prokurimi.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Skenderajt.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Skenderajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Skenderajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Skenderajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Skenderajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Kontrollet e brendshme në drejtoritë përkatëse duhet të avancohen tutje me qëllim të ofrimit të informatave të sakta dhe me kohë për detyrimet kontigjente dhe faturat e pranuar nga kontraktuesit, me qëllim shpalosjen e saktë dhe të plotë të tyre në pasqyrat vjetpre financiare. Në aspektin e pajtueshmërisë, përmirësime janë të nevojshme në regjistrimin e pagesave në kategoritë përkatëse, menaxhimin e personelit, blerjeve përmes prokurimit, menaxhimin e duhur dhe realizimin me kohë të kontratave publike, proceset e subvencionimit dhe arkëtimin me kohë të të hyrave.

Ky raport ka rezultuar me njëmbëdhjetë (11) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate

Gjetja

Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga "Rezerva" me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore, përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, plani kontabël i Thesarit përcakton kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që organizatat buxhetore duhet të aplikojnë.

Komuna nuk kishte planifikuar fonde rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, në përputhje me kërkesat ligjore. Si pasojë, shpenzimet në vlerë totale 493,807€ nuk janë klasifikuar në kategorinë e duhur ekonomike. Keqklasifikimet kanë rezultuar te këto kategori ekonomike:

- Për shpenzime që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve, të cilat kanë të bëjnë me pagesat për kontratën kolektive të punonjësve të arsimit, janë paguar 343,524€ nga buxheti i kategorisë së investimeve kapitale, 119,570€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve, dhe 15,713€ nga buxheti i kategorisë së subvencioneve dhe transfere; si dhe

- Për shpenzime që për nga natyra i takojnë kategorisë së investimeve kapitale, janë paguar 15,000€ nga buxheti i mallrave dhe shërbimeve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së ndarjes së fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, dobësive në kontrollet e brendshme gjatë planifikimit buxhetor, si dhe vonesave në pagesën me kohë të obligimeve.

Ndikimi Regjistrimi i shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e fondeve rezervë për mbulimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbartimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kufijtë buxhetorë të përcaktuar, si dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mbivlerësim i detyrimeve kontigjente në pasqyrat vjetore financiare

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga OB-të, përcakton që OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Në listën e detyrimeve kontigjente është përfshirë edhe lënda e cila kishte përfunduar si proces gjyqësor dhe kishte urdhër përmbartimor për ekzekutim në vlerë 127,978€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë nga zyra ligjore në përditësimin e informatave në regjistrin e kontigjencave dhe ofrimit të informacionit për prezantim financiar.

Ndikimi Mos përditësimi me kohë i regjistrin të detyrimeve kontigjente ka ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontigjente dhe shpalosjen jo të saktë në pasqyrat vjetore financiare.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që lista e detyrimeve kontigjente azhurnohet me kohë, dhe se lëndët për të cilat kanë përfunduar me urdhër përmbartimor të mos prezantohen më tej si detyrime kontigjente.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në përgatitjen e specifikacionit teknik dhe mungesë e projektit detaj ekzekutues për kontratën e punëve

Gjetja

Sipas Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 28, pika 7, përcaktohet që Autoriteti Kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6 të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”.

Rregullorja nr. 002/2024 për prokurimin publik, neni 19.14, përcakton se specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutues.

Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit publik, është identifikuar se:

- Në procedurën e prokurimit “Furnizim me ushqim dhe pije si dhe me material higjieniko-sanitar për nevojat e shkollave dhe të gjitha institucioneve tjera në kuadër të Komunës së Skenderajt”, në vlerë të parashikuar 346,500€, në specifikacionin teknik janë përfshirë 14 pozicione ku përmenden brende specifike pa u shoqëruar me formulimin “ose ekuivalent”, dhe
- Për kontratën e punëve “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet”, në vlerë 1,230,269€, dosja e prokurimit kishte përfshirë paramasen dhe parallogarinë e punëve, por jo edhe projektin detaj ekzekutiv.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve të pamjaftueshme gjatë përgatitjes së specifikimeve teknike dhe zbatimit të kërkesave përkatëse në hartimin e projektit detaj ekzekutues nga njësia kërkuese.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar mund të ndikojnë në favorizimin apo kufizimin e konkurrencës ndërmjet ofertuesve. Gjithashtu, mungesa e projektit detaj ekzekutiv rrit rrezikun që implementimi i kontratës së punëve të përcillet me vështirësi dhe paqartësi në aspektin e realizimit dhe mbikëqyrjes së punimeve.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese gjatë hartimit të specifikimeve teknike të mos përcaktojnë markë apo brend specifik pa i shoqëruar me formulimin ose ekuivalent, dhe për projektet kapitale të përgatisin projekt detaj ekzekutiv.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në procedurat e rekrutimit

Gjetja Rregullorja (QRK) - nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimet në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar - neni 2, pika 2 kërkon që: Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NjMBNj) e komunës përkatëse dhe Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në komunat e Republikës së Kosovës, MASHTI dhe Agjencia për Arsim, Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, janë përgjegjëse për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare të komunës. Gjithashtu, sipas kësaj rregullore, me nenin 22, kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs, veç tjerash për kandidatët kërkohet që (pika 1.6) të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.

Nga auditimi i procedurave të rekrutimit për nëpunësit e shërbimit publik, identifikua se proceset e rekrutimit ishin udhëhequr nga drejtoria e arsimit, pa përfshirjen e njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore në proces. Gjithashtu, në tri (3) procedura të rekrutimit për punonjës të sektorit të arsimit, në njoftimin për konkurs punësimi nuk është kërkuar si kriter që aplikuesit të mos kenë dëshmi për masë disiplinore.

Sipas zyrtarëve komunal kjo ka ndodhur për shkak të stafit të pamjaftueshëm të zyrës së personelit për tu përfshirë në proceset e rekrutimit edhe për stafin arsimor apo nëpunësit e shërbimit publik.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar në proceset e rekrutimit mund të ndikojnë në transparencën dhe ligjshmërinë e procesit të përzgjedhjes dhe të rrisin rrezikun e trajtimit jo të barabartë të kandidatëve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se procedurat e rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik të organizohen dhe udhëhiqen nga zyra e personelit në bashkëpunim me drejtorinë e arsimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Mos vazhdimi i sigurimit të ekzekutimit të kontratave publike**

Gjetja Sipas nenit 63 të LPP-së dhe Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 29, siguria e ekzekutimit (SE) kërkohet si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e SE do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. SE do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës.

Nga auditimi i projekteve kapitale është identifikuar se në tri (3) raste sigurimet e ekzekutimeve të kontratave nuk ishin vazhduar kur projektet kapitale nuk kishin arritë të finalizoheshin sipas afatit të kontratave. Rastet janë te këto kontrata publike:

- Trotuaret dhe ndriçimi led në bashkësitë lokale Likoc, Klinë e Epërme, Runik dhe Turiqec, në vlerë 649,649€, siguria e ekzekutimit

për 10% të vlerës së kontratës kishte skaduar në shtator 2025 dhe nuk ishte vazhduar, ndonëse kontrata vazhdon edhe në vitin 2026.

- Ndërtimi i çerdhes për fëmijë - vazhdimi i aneksit të dytë, në vlerë 386,283€, siguria e ekzekutimit për 10% të vlerës së kontratës kishte skaduar në mars 2025, dhe nuk ishte vazhduar, ndonëse kontrata ishte në vazhdim.
- Ndërtimi i shëtitorës natyrale dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë lumit Klina, në 49,612€, me kushtet e veçanta të kontratës është kërkuar që sigurimi i ekzekutimit prej 10% të vlerës së kontratës të ketë validitet për 19 muaj, ndërsa kontraktuesi ka ofruar sigurinë e ekzekutimit në afat 12 muaj.

Kjo ka ndodhur për shkak të monitorimit të mangët në menaxhimin e projekteve nga menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë.

Ndikimi Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit të kontratës nuk garanton mbulimin e dëmeve dhe shpenzimeve në rast të mos përmbushjes së kontratës nga ana e kontraktuesit.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë që në rastet kur kontratat publike nuk arrijnë të përfundohen brenda periudhës së kontraktuar, siguria e ekzekutimit të kontratës vazhdohet edhe për një periudhë shtesë në të cilën parashihet finalizimi i kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Subvencionimi dy herë brenda vitit për të njëjtin përfitues

Gjetja Sipas nenit 5, pika 2 të Rregullores së Komunës për ndarjen e subvencioneve e datës 30.11.2020, përfitues i subvencioneve mund të jetë vetëm një herë në vit personi fizik dhe juridik, me përjashtim të rasteve për personin fizik në fushën e shëndetësisë, për nevoja të shërimit dhe sigurimit të ushqimeve (mirëqenie sociale) dhe në fushën e bujqësisë.

Komuna gjatë vitit 2025 ka subvencionuar dy (2) herë brenda vitit të njëjtin përfitues/OJQ. Financimi është bërë për realizimin e aktivitetit “Muaji i mërgatës” në vlerë 13,100€ dhe “Aktivitete rinore dhe kulturore” në vlerë 7,500€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit të mjaftueshëm nga ana e zyrtarëve përgjegjës gjatë shqyrtimit dhe aprovimit të kërkesave për subvencione, si dhe mungesës së një mekanizmi efektiv për verifikimin e përfitimeve paraprake të përfituesve brenda vitit buxhetor.

Ndikimi Ndarja e subvencioneve në kundërshtim me rregulloren komunale rrit rrezikun e trajtimit jo të barabartë të përfituesve dhe mund të kufizojë mundësinë e përfitimit për OJQ tjera.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që, para aprovimit të subvencioneve, të kryhet verifikimi i plotë i përfitimeve paraprake të përfituesve, në mënyrë që të parandalohet subvencionimi më shumë se një herë brenda vitit për të njëjtin përfitues.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mos vlerësimi i performancës së kontraktuesve përmes e-prokurimit nga menaxherët e kontratave

Gjetja

Neni 70, pika 23 dhe 25 e Rregullores 002/2024 për prokurimin publik, përcakton që, menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij, derisa mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për shqyrtimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesve të plotësuar platformën e e-prokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij/saj.

Për gjashtë (6)⁵ kontrata publike të përfunduara, menaxherët e projekteve dhe mbikqyrësit e menaxherëve nuk kanë bërë vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulën e menaxhimit të kontratës në platformën e-prokurimi.

Kjo kishte ndodhur për shkak se menaxherët e kontratave nuk i kanë kushtuar rëndësinë e duhur kërkesave rregullative që projektet që përfundohen, të vlerësohet edhe performanca e kontraktorit në realizimin e kontratës publike.

Ndikimi

Mos vlerësimi i performancës së kontraktuesve nga menaxherët e kontratave, mund të ndikojë që në raste të caktuara kontraktues të papërgjegjshëm të përfitojnë kontrata publike edhe në të ardhmen.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave dhe mbikqyrësit e drejtpërdrejtë të menaxherëve, bëjnë vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes platformes e-prokurimi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,653,051€, dhe gjatë vitit 2025 ishin shpenzuar 4,441,503€. Investimet kapitale përbëhen nga investimet në infrastrukturën rrugore, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, etj.

Çështja B5 - Vonesa në realizim të projekteve kapitale

Gjetja

Sipas nenit 70.23 të Rregullores nr. 002/2024 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Tetë (8) projekte kapitale nuk ishin realizuar në afatin kohor të përcaktuar me kontratë. Rastet janë të këto projekte:

- Punimet në rrjetin e ujësjellësit në bashkësinë lokale Qirez, në vlerë 1,616,230€, kontrata duhej të përfundonte në fund të vitit 2025, derisa punimet ende vazhdojnë.
- Rregullimi subqendrës në Runik, në vlerë 817,720€, kontrata duhej të përfundonte në fund të vitit 2025, derisa punimet ende vazhdojnë.
- Rregullimi subqendrës në Qirez, në vlerë 685,803€, kontrata duhej të përfundonte në fund të vitit 2025, punimet ende vazhdojnë.
- Trotualet dhe ndriçimi led në bashkësitë lokale Likoc, Klinë e Epërme, Runik dhe Turigec, në vlerë 649,649€, kontrata duhej të përfundonte në fund të vitit 2024, derisa punimet ende vazhdojnë.
- Rregullimi i tribunave në stadiumin e qytetit, në vlerë 596,428€, kontrata duhej të përfundonte në fund të vitit 2025, punimet ende vazhdojnë.
- Kontrata për Ndërtimin e çerdhes për fëmijë - vazhdimi i aneksit të dytë, në vlerë 386,283€, sipas kontratës duhej të përfundonte deri në muajin mars të vitit 2025, derisa punimet ende vazhdojnë.
- Kontrata Poligoni sportiv në shkollën Ahmet Delia në Skenderaj, në vlerë 90,858€, duhej të përfundonte deri në fund të vitit 2024, punimet ende nuk janë përfunduar si tërësi.
- Kontrata për Kanalizimin fekal në Izbicë, Rakinicë, dhe Leqinë, faza I, në vlerë, në vlerë 61,932€, me gjithë vazhdimin e afatit të implementimit duhej të përfundonte deri në fund të vitit 2025, punimet ende vazhdojnë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme nga ana e menaxherëve të kontratave, kontesteve pronësore si dhe mungesës buxhetore të ndodhura nga pagesat e realizuara nga fondi i investimeve kapitale për shkak të vendimeve gjyqësore.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mos realizimin e planifikimeve vjetore dhe objektive të përcaktuara.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e

kontratave në mënyrë që projektet kapitale të realizohen sipas afateve kohore të përcaktuara me kontratë. Çështjet apo faktorët që mund të vështirësojnë apo të kenë ndikim në mos implementimin me kohë të projekteve të definojnë paraprakisht me qëllim që punimet të përfundohen brenda afatit të caktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mangësi në realizim të kontratës me çmim të poentuar

Gjetja

Rregullorja nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 54.15, sqaron se kurdo që AK nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani +/-30%. Duke pasur parasysh faktin së peshimi i kategorive duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që vlera e realizuar (shpenzuar) nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit.

Kontrata publike me çmim të poentuar "Furnizim dhe mirëmbajtja e kamerave të hapësirave - ritender", në vlerë 50,000€, në total ishte realizuar në vlerën e planifikuar, megjithatë, shpenzimet e planifikuara për kategorinë e dytë të peshuar me 30% apo 15,000€, ishin realizuar në vlerë 19,637€, duke tejkalluar limitin e lejuar për 4,637€. Gjithashtu, kategoria e tretë e peshuar me 20% apo 10,000€, ishte realizuar në vlerë 25,766€, duke tejkalluar limitin e lejuar për 15,766€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të monitorimit të pamjaftueshëm nga menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejt për të krahasur vlerat e planifikuara me ato të realizuara.

Ndikimi

Mos ruajtja e përqindjes apo peshimit të kategorive të kontraktuara shkakton kosto shtesë buxhetore për shkak se raporti i peshimit ishte faktori kryesor në përzgjedhjen e tenderit apo ofertës më të lirë gjatë procedurës së prokurimit.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave monitorojnë dhe aprovojnë punët dhe furnizimet në limitet e përcaktuara me poentim. Gjatë realizimit të kontratës, të ruhet e njëjta përqindje apo raport i peshimit të kategorive, duke mos tejkalluar limitin e vlerës së kontraktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategoritë ekonomike:

Çështja B7 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare dhe kosto shtesë buxhetore për shkak të vendimeve gjyqësore përmbarimore

Gjetja	<p>Neni 41 i Rregullës financiare nr. 01/20213/MF shpenzimi i parasë publike, përcakton që, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimin të faturës.</p> <p>Në katër (4) pagesa në vlerë 49,743€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditësh nga data e pranimin. Vonesat ishin nga 1 deri 10 muaj.</p> <p>Gjithashtu, sipas regjistrin të siguruar nga Komuna, gjatë vitit 2025, si rezultat i procedurave përmbarimore dhe vendimeve gjyqësore nga paditë e punonjësve të arsimit për kompensimet ndërlidhur me kontratën kolektive, në emër të kamatave, tarifave të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore janë paguar kosto shtesë në vlerë 161,485€.</p> <p>Mos pagesa me kohë e obligimeve ka ndodhur për shkak të vonesave në përcjelljen e faturave në zyrën e financave, dhe hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore.</p>
Ndikimi	Vonesa në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, ndikon që komuna të jetë subjekt i padive nga kontraktuesit, duke shkaktuar kosto shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.
Rekomandimi B7	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe të sigurojë se detyrimet ndaj kontraktuesve paguhen brenda afateve kohore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2025 në total janë 2,424,483€. Vlera e të arkëtueshmeve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë (82%), taksat komunale në biznes (9%), dhe (9%) nga qiraja nga shfrytëzimi i pronave publike.

Çështja B8 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Sipas nenit 26 të Ligjit 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove. Derisa, me neni 27, përcakton që nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në kontratë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna e Skenderajt nuk ishte sa duhet efektive në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme, të cilat në fund të vitit 2025 ishin 2,424,483€. Ndonëse ishin ndërmarrë veprime gjatë vitit 2025 duke njoftuar taksapaguesit për obligimet e papaguara, niveli i arkëtitimit edhe më tutje mbetet i ulët.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave vetanake ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më efikas të llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	19,881,472	20,860,109	20,601,348	20,949,548	18,709,687
Grante Qeveritare - Buxheti	18,172,006	18,951,485	18,892,739	18,359,973	16,257,693
Të bartura nga viti i kaluar	0	194,931	193,700	322,124	417,798
Të hyrat vetanake	1,709,466	1,709,466	1,514,420	1,658,354	1,607,215
Donacionet vendore	0	1,881	0	0	420,575
Donacionet e jashtme	0	2,346	488	609,096	6,406

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 978,638€. Kjo rritje është ndikuar nga vendimi i qeverisë në vlerë 779,479€ për ngritjen e koeficientit të pagave, pastaj nga të hyrat e bartura të vitit paraprak në vlerë 194,931€, si dhe 4,228€ nga donacionet.

Në vitin 2025 Komuna Skenderaj ka shpenzuar afër 99% të buxhetit përfundimtar ose 20,601,348€. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	19,881,472	20,860,109	20,601,348	20,949,548	18,709,687
Pagat dhe mëditjet	11,020,774	11,800,871	11,800,066	11,719,195	9,758,084
Mallrat dhe shërbimet	2,846,807	2,940,776	2,918,638	2,491,898	2,474,417
Komunalitë	287,300	287,300	285,677	303,122	317,868
Subvencionet dhe transferet	1,147,000	1,178,111	1,155,464	1,097,739	1,407,504
Investimet Kapitale	4,579,591	4,653,051	4,441,503	5,337,594	4,751,813

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për paga dhe mëditje është rritur për 780,097€. Rritja është ndikuar nga vendimi e qeverisë lidhur me ngritjen e koeficientit të pagave për zyrtarët publik, dhe 618€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.99%.
- Buxheti për mallrave dhe shërbimeve është rritur për 93,969€. Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar në vlerë 92,003€, dhe 1,966€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.25%.
- Buxheti final për shërbimet komunale nuk ka pasur ndryshime nga buxheti fillestar prej 287,000€. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 99.44%.
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 31,111€. Rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura të vitit të kaluar për 30,000€, dhe 1,111€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 98.08%.
- Buxheti për investime kapitale është rritur për 73,460€. Kryesisht rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në vlerë 72,928€, dhe 533€ nga donacionet. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 95.45%. Programi i Investimeve Publike përfshin 39 projekte kapitale të vitit aktual dhe viteve paraprake. Projektet kryesisht janë dedikuar për investimet në infrastrukturën rrugore, ndriçimit publik, salla sportive, ndërtimin dhe renovimin e objekteve arsimore dhe kulturore, rrjetet e ujësjellësit, kanalizimit, parqe, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2025 ishin 1,447,641€, derisa të planifikuara ishin 1,709,466€. Të hyrat kanë të bëjnë kryesisht nga taksat për leje ndërtimore, tatimi në pronë, koncesionet, participimet nga qytetarët, si dhe taksa tjera komunale. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave ka shënuar ulje për 127,636€.

Në vitin 2025 Komuna ka përfituar 278,866€ të hyra nga gjobat në trafik, 40,350€ nga gjobat e gjykatave, dhe 442€ nga Agjencioni i Pyjeve, apo në total 319,658€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	1,709,466	1,709,466	1,447,641	1,575,277	1,786,438
Të hyrat tatimore	344,960	344,960	288,442	217,509	374,702
Të hyrat jo tatimore	1,364,506	1,364,506	1,159,199	1,357,590	1,411,736
Të hyrat tjera	0	0		178	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 për Komunën Skenderaj ka rezultuar me njëmbëdhjetë (11) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit të vitit 2024 ishte diskutuar në kuvendin komunal. Gjithashtu, Komuna kishte përgatitur edhe raportin periodik për progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të vitit 2024.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, dy (2) rekomandime janë zbatuar; një (1) në proces të zbatimit, dhe tetë (8) nuk janë zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që lista e detyrimeve kontigjente azhurnohet me kohë, dhe se lëndët për të cilat janë bërë marrëveshjet mes paditësit dhe komunës, e të cilat janë në procedurë të përbarimit të mos prezantohen si detyrime kontigjente.	Nuk janë ndërmarra veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që vlerësimi dhe miratimi i kërkesave për subvencionim të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore dhe brenda fushëveprimit ligjor të komunës. Po ashtu, shtohet mbikëqyrja në procesin e vlerësimit të kërkesave, për të parandaluar miratimin e ndihmave në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ose për qëllime që tejkalojnë kompetencat e komunës.	Pjesërisht janë ndërmarra veprime.	Pjesërisht i zbatuar


3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike të nënshkruhen vetëm atëherë kur kontraktuesi të ofrojë sigurinë e ekzekutimit në afatin e përcaktuar me dosje të tenderit.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimimi
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luajnë një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale. Po ashtu nevojitet mbikëqyrje më aktive gjatë realizimit të kontratave nga ana e menaxherëve të kontratave, ashtu që vlera e realizuar e kategorisë të mos tejkalojë peshën apo limitin e vlerës së kontraktuar.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtëpërdrejtë të menaxherëve, vendosin informatat rreth implementimit të projekteve dhe bëjnë vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit të menaxhimit të kontratave në platformën e-prokurimi.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimimi
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e kontratave në mënyrë që të sigurojë që kontratat publike realizohen sipas afateve kohore dhe kushteve kontraktuale.	Edhe në vitin 2025 kemi vonesa në realizim të kontratave.	Nuk ka filluar zbatimimi
8.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestini i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet nga kategoritë ekonomike adekuate.	Si rezultat i vendimeve gjyqësore, edhe këtë vit janë realizuar pagesa nga kategori buxhetore joadekuate.	Nuk ka filluar zbatimimi
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të bëjë një rishikim dhe të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë në regjistrat kontabël, dhe të bëjë një rivlerësim të të gjithë listës së pasurive të komunës.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimimi

11.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe të siguroj se detyrimet ndaj kontraktuesve paguhen brenda afateve kohore, duke shmangur në këtë mënyrë kostot shtesë për shkak të procedurave gjyqësore.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimi
-----	-----------------------	--	-----------------------------	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Drilon Osmani, Anëtar i ekipit



Endrita Gjyrevci, Anëtare e ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES
Zyra Kombëtare e Auditimit - Nacionalna Kancelarija Revizije - National Audit Office
SKENDERAJ

Nr. 04-052/07-0016251/06
Data: 05-05-2026



KOMUNA SKENDERAJ

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve


Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderajt, për vitin 2025.
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Sami Lushtaku



Zyrtar Kryesor Administrativ, Komuna Skenderaj

Data: 04/05/2026

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Asfaltimi i rrugës në lagjen 3 - Prekaz, në vlerë 270,860€, Riparimi dhe zgjerimi i vend-ndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre në vlerë 174,373€, Unaza e brendshme 3 krahu ka Llausha, në vlerë 454,047€, Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF në Skenderaj, në vlerë 317,898€, Ndërtimi i shëtitores natyrale dhe krijimi i hapësirave rekreative përgjatë lumit Klina, në 49,612€, Mirëmbajtja dhe servisi i nxemjeve në të gjitha shkollat dhe institucionet tjera vartëse të drejtorisë së arsimit, në vlerë 45,00€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.